

AKTI I THEMELIMIT

TE

SHOQËRISË "SiCRED Distribution" sh.p.k.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "SiCRED Distribution" sh.p.k., së cilës në vijim do ti referohemi si "Shoqëria", themelohet nga Ortaku i vetëm i saj:

a. Shoqëria **SiCRED sh.a.**, me seli aktiviteti në Tiranë, Rruga "Brigada e VIII", Vila 3/1, Tiranë, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 30417 datë 22.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z.Genc KOXHAJ, i pajisur me kartën e identitetit nr. 033958047 dhe numër personal H40405202H.

Neni 1 Emërtimi

- 1.1 Shoqëria emërtohet "**SiCRED Distribution**" sh.p.k.
- 1.2 Shoqëria do të ketë vulën dhe emblemën e saj, si dhe formatin zyrtar të akteve për komunikimin me të tretët.
- 1.3 Vula e Shoqërisë do të mbajë në mënyrë të lexueshme emrin e plotë të saj, si dhe përcaktimin tregtar "**sh.p.k.**".
- 1.4 Emblema e Shoqërisë do të përbëhet nga **vektorë që formojnë formën e një globi me ngjyrat blu dhe të kuqe në sfond të bardhë**, poshtë të cilit do të jetë shkruar emri i Shoqërisë "**SiCRED Distribution**", i pashoqëruar nga emërtimi tregtar "**sh.p.k.**".
- 1.5 Formatu zyrtar i shkresave të shoqërisë do të ketë në çdo rast "*header & footer*" me emrin e plotë të saj, shoqëruar nga emërtimi tregtar "**sh.p.k.**".

Neni 2 Forma e Shoqërisë

- 2.1 Shoqëria "**SiCRED Distribution**" sh.p.k. do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

Neni 3 Baza ligjore

- 3.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me:
 - a. Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
 - b. Ligjin nr.9723, date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", (i ndryshuar).
 - c. Ligjin nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar).
 - d. Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ne RSH si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij.





**Neni 4
Kohëzgjatja**

- 4.1 Shoqëria themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.
- 4.2 Ortaku i vetëm i saj gëzon të drejtën e prishjes së Shoqërisë në çdo kohë.

**Neni 5
Selia**

- 5.1 Selia e shoqërisë do të jetë: Ruga "Brigada e VIII", Vila 3/1, kati i tretë, Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Selia mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të vetëm të saj
- 5.3 Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë vendit, duke respektuar ligjin e zbatueshëm shqiptar.
- 5.4 Vendimi për krijimin ose edhe mbylljen e tyre merret nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë

**Neni 6
Objekti i Veprimtarisë**

- 6.1 Shoqëria në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, do të kryejë aktivitetin si më poshtë specifikuar:
- a. Shitblerja me shumicë dhe/ose pakicë e prodhimeve artizanale artistike shqiptare dhe/ose të huaja, direkt nga prodhuesi dhe/ose nga koleksionistë të pajisur me dokumentacionin përkatës;
 - b. Shitblerja **online** e prodhimeve artizanale artistike shqiptare dhe/ose të huaja si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe jashtë saj;
 - c. Shoqëria në përputhje me nënpikat a dhe b me lart, bazuar mbi këtë statut do të kryejë edhe ndërmjetësimin, pra ky term do të përfshijë të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me subjektin që kërkon të shesë prodhime artizanale në emër dhe për llogari të blerësit si konsumator, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate shetje me shumicë apo pakice të pasurive kulturore materiale të luajtshme, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
 - d. Shoqëria në përputhje me nënpikat a dhe b me lart, bazuar mbi këtë statut do të kryejë edhe promovimin, e produkteve artizanale artistike shqiptare dhe/ose të huaja, direkt nga prodhuesi dhe/ose nga koleksionistë të pajisur me dokumentacionin përkatës, duke kontaktuar me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për produktet dhe shërbimet e shoqërisë;
 - e. Shoqëria në përputhje me nënpikat me lart, do të kryejë çdo veprim tjetër në shërbim të zbatimit të statutit dhe të ligjit 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", në RSH.
- 6.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Ortakut të vetëm të saj.



**SiCRED
Distribution**

Shoqëria "SiCRED Distribution" sh.p.k.

**Neni 7
Kapitali themeltar**

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në të holla i Ortakut të vetëm themelues, në vlerë **100,000.00 Lekë**.
- 7.2 Ortaku i vetëm themelues SiCRED sh.a. është zotërues i (një) kuote me vlerë nominale **100,000.00 Lekë** që përben 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 7.3 Kapitali mund të zmadhohet në çdo kohë me vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

**Neni 8
Hartimi i Aktit të Themelimit të Shoqërisë**

- 8.1 Ky Akt Themelimi u hartua në gjuhën shqipe, në 5 (pesë) kopje identike dhe u nënshkrua rregullisht nga Ortaku i vetëm i saj SiCRED sh.a. (përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SiCRED sh.a.)

**ORTAKU
I VETËM THEMELUES**

SiCRED sh.a.

z. Genc KOXHAI

Përfaqësues i autorizuar i shoqërisë SiCRED sh.a. zotërues në 100% të kuotave

Tirane me 8-2-2021

STATUTI

I SHOQËRISË

"SiCRED Distribution" sh.p.k.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "SiCRED Distribution" sh.p.k., së cilës në vijim do ti referohemi si "Shoqëria", themelohet nga Ortaku i vetëm i saj:

a. Shoqëria **SiCRED sh.a.**, me seli aktiviteti në Tiranë, Rruga "Brigada e VIII", Vila 3/1, Tiranë, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 30417 datë 22.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z.Genc KOXHAJ, i pajisur me kartën e identitetit nr. 033958047 dhe numër personal H40405202H.

Neni 1 Emërtimi


- 1.1 Shoqëria emërtohet "**SiCRED Distribution**" sh.p.k.
- 1.2 Shoqëria do të ketë vulën dhe emblemën e saj, si dhe formatin zyrtar të akteve për komunikimin me të tretët.
- 1.3 Vula e Shoqërisë do të mbajë në mënyrë të lexueshme emrin e plotë të saj, si dhe përcaktimin tregtar "**sh.p.k.**".
- 1.4 Emblema e Shoqërisë do të përbëhet nga **vektorë që formojnë formën e një globi me ngjyrat blu dhe të kuqe në sfond të bardhë**, poshtë të cilit do të jetë shkruar emri i Shoqërisë "**SiCRED Distribution**", i pashoqëruar nga emërtimi tregtar "**sh.p.k.**".
- 1.5 Formatin zyrtar i shkresave të shoqërisë do të ketë në çdo rast "*header & footer*" me emrin e plotë të saj, shoqëruar nga emërtimi tregtar "**sh.p.k.**".

Neni 2 Forma e Shoqërisë

2.1 Shoqëria "**SiCRED Distribution**" sh.p.k. do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

Neni 3 Baza ligjore

- 3.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me:
 - a. Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
 - b. Ligjin nr.9723, date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", (i ndryshuar).
 - c. Ligjin nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar).





- d. Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ne RSH si dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij.

**Neni 4
Kohëzgjatja**

- 4.1 Shoqëria themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.
4.2 Ortaku i vetëm i saj gëzon të drejtën e prishjes së Shoqërisë në çdo kohë.

**Neni 5
Selia**

- 5.1 Selia e shoqërisë do të jetë: Ruga "Brigada e VIII", Vila 3/1, kati i tretë, Tiranë, Shqipëri.
5.2 Selia mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të vetëm të saj
5.3 Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë vendit, duke respektuar ligjin e zbatueshëm shqiptar.
5.4 Vendimi për krijimin ose edhe mbylljen e tyre merret nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë

**Neni 6
Objekti i Veprimtarisë**

- 6.1 Shoqëria në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, do të kryejë aktivitetin si më poshtë specifikuar:
- a. Shitblerja me shumicë dhe/ose pakicë e prodhimeve artizanale artistike shqiptare dhe/ose të huaja, direkt nga prodhuesi dhe/ose nga koleksionistë të pajisur me dokumentacionin përkatës;
 - b. Shitblerja **online** e prodhimeve artizanale artistike shqiptare dhe/ose të huaja si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe jashtë saj;
 - c. Shoqëria ne përputhje me nënpikat a dhe b me lart, bazuar mbi këtë statut do te kryeje edhe ndërmjetësimin, pra ky term do te përfshije të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me subjektin qe kërkon te shesë prodhime artizanale në emër dhe për llogari të blerësit si konsumator, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate shitje me shumicë apo pakice te pasurive kulturore materiale te luajtshme, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
 - d. Shoqëria ne përputhje me nënpikat a dhe b me lart, bazuar mbi këtë statut do te kryeje edhe promovimin, e produkteve artizanale artistike shqiptare dhe/ose të huaja, direkt nga prodhuesi dhe/ose nga koleksionistë të pajisur me dokumentacionin përkatës, duke kontaktuar me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për produktet dhe shërbimet e shoqërisë;
 - e. Shoqëria ne përputhje me nënpikat me lart, do te kryeje çdo veprim tjetër ne shërbim te zbatimit te statutit dhe te ligjit 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ne RSH.

6.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Ortakut të vetëm të saj.

Neni 7

Kapitali themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në të holla i Ortakut të vetëm themelues, në vlerë **100,000.00 Lekë**.

7.2 Ortaku i vetëm themelues SiCRED sh.a. është zotërues i (një) kuote me vlerë nominale **100,000.00 Lekë** që përben 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

7.3 Kapitali mund të zmadhohet në çdo kohë me vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë

Neni 8

Organet Drejtuese të Shoqërisë

8.1 Në zbatim të ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- b) Administratori – organi ekzekutiv dhe drejtues i veprimtarisë së përditshme të shoqërisë.

8.2 **Asambleja e Përgjithshme** si organi më i lartë vendimmarrës merr vendime në rastet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- gj) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.3 **Administratori** si organi ekzekutiv dhe drejtues i veprimtarisë së përditshme të shoqërisë merr vendime në rastet e mëposhtme:

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësimin e Shoqërisë në realizimin e marrëveshjeve me të tretët;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



Shoqëria "SiCRED Distribution" sh.p.k.

- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) të hapë llogari bankare në Lekë dhe monedha të huaja për shoqërinë pranë çdo banke që e vlerëson të dobishme për mbarrëvajtjen e transaksioneve të shoqërisë
- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera administrative;
- h) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 9 Administrimi

- 9.1 Shoqëria "SiCRED Distribution" sh.p.k. do të administrohet nga **znj. Onkita KODRA**. Afati i emërimit të administratorit do të jetë me mandat 1 vjeçar me të drejtë ri-emërimi.
- 9.2 Administratori, për qëllime të ushtrimit të detyrës së tij dhe në konformitet me këtë statut, si dhe ligjin në fuqi do të kryejë veprimet bankare apo dhe të tjera veprime, sipas rastit dhe kur e kërkojnë rrethanat e mire administrimit të Shoqërisë. Çdo veprim bankar i kryer për qëllime të këtij neni do të kryhet me një firmë e cila do të jete në çdo rast e **znj. ONKITA KODRA**.
- 9.3 Specimeni i nënshkrimit të Administratorit të Shoqërisë, do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe pranë subjekteve bankare, në respektim të legjislacionit në fuqi.

Neni 10 Përgjegjësitë e Administratorit

- 10.1 Përfaqësimi i shoqërisë tek të tretet kryhet nga administratori i shoqërisë administratori i shoqërisë znj. Onkita Kodra. Në këtë cilësi ajo do të kryejë detyrën e administratorit për një periudhë një vjeçare, nga momenti i emërimit, me të drejtë ri-emërimi.
- 10.2 Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 10.3 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm.
- 10.4 Administratori për mire administrimin e shoqërisë do të veprojë në baze të rregullave të përcaktuara me mirëkuptim me ortakun e vetëm, dhe në përputhje dhe do t'ju përmbahet dispozitave të statutit dhe të ligjit tregtar të zbatueshëm në fuqi.
- 10.5 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:



Shoqëria "SiCRED Distribution" sh.p.k.

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Neni 11 Likuidimi

- 11.1 Shoqëria do të likuidohet, në rast prishje, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Statut, si dhe në parashikimet e legjislacionit në fuqi.
- 11.2 Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, sipas vullnetit të shprehur nëpërmjet vendimit të Ortakut të vetëm të saj apo dhe për çfarëdolloj arsyeje të përligjur nga legjislacioni i zbatueshëm tregtar.
- 11.3 Emërtimi i shoqërisë, pasohet nga shënimi "Shoqëri në likuidim e sipër". Ky shënim dhe emri i likuiduesit ose i likuiduesve do të figurojnë në të gjitha aktet e dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.
- 11.4 Ekzistenca e Shoqërisë si person juridik, mbetet për nevojat e likuidimit deri në përfundim të këtij procesi.

Neni 12

Hartimi i Statutit të Shoqërisë

- 12.1 Ky Statut u hartua në gjuhën shqipe, në 5 (pesë) kopje identike dhe u nënshkrua rregullisht nga Ortaku i vetëm i saj SiCRED sh.a. (përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SiCRED sh.a.)

ORTAKU

I VETËM THEMELUES

SiCRED sh.a.

Z. Genc KOXHAJ

Përfaqësues i autorizuar i shoqërisë SiCRED sh.a. zotëues në 100% të kuotave

Tirane me 8-2-2021